VENDIM
Nr. 369, datë 6.5.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 47, DATË 22.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2020, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2 265 veta.

2. Në pikën 3, pas fjalëve "...1 (një) specialist në DPPPP …" shtohen fjalët "…14 (katërmbëdhjetë) specialistë të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, …".

3. Në lidhjen nr.1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhen këto ndryshime:

a) Në ndarjen "Gr.05 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", nënndarja si më poshtë vijon:

	AZHBR	14	Specialist	8 orë/ditë	4 muaj

zëvendësohet me këtë nënndarje:

	AZHBR	14	Specialist	orë/ditë	1 maj deri 31 dhjetor

b) Në ndarjen "Gr.13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" periudha kohore për 35 punonjësit mjekë/infermierë/shoferë të Qendrës Kombëtare Urgjencës Mjekësore bëhet 6-mujore.

c) Në ndarjen "Gr.13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" shtohet nënndarja sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Efektet financiare të këtij vendimi për 14 specialistët e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural fillojnë në datën 1 maj 2020 dhe përballohen nga buxheti i agjencisë.

III. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bëjë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhës kohore të punësimit dhe kategorisë përkatëse të pagës së tyre dhe ta depozitojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

IV. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr.1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
13	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**	**700**			
	Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor	700	Specialist (Infermierë/teknik i shkencave mjeksore)	8 orë/ditë	6 Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	**700**			